

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Mbi raportin e monitorimit të

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

për tremujorin e tretw të vitit 2014

1. Karakteristikat kryesore të performancës.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas dy programeve të miratuara, e konkretisht:

1. Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”
2. Programi “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”

Për tremujorin e tretw të vitit 2014, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor, me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

	Emërtimi	Plani 2013	Fakti 2013	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	95,733	50,830	97.0%	95.8%	53.1%
1.1	<i>Personeli</i>	68,000	39,731	68.9%	74.9%	58.4%
1.2	<i>Operative</i>	27,733	11,099	28.1%	20.9%	40.0%
2	Shpenzime kapitale	3,000	203	3.0%	0.4%	6.8%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	3,000	203	3.0%	0.4%	6.8%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	98,733	51,033	100.0%	96.2%	51.7%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		2,007	0.0%	3.8%	
4	TOTALI	98,733	53,040	100.0%	100.0%	53.7%

Burimi: Ministria e Financave, tw dhwnat nw mijw lek

Sikurse evidentohet, për aktivitetin e KQZ-së në vitin 2014, janë parashikuar rreth 98.7 milion lekë, nga të cilat, për periudhën 9-mujore janë shpenzuar rreth 53 milion lekë, ose 51.7 % e fondeve vjetore tw planifikuara. Gjithashtu, evidentohet se rreth 97% e fondeve buxhetore, janë planifikuar për shpenzimet korente, nga të cilat pjesa më e madhe prej, rreth 69% për pagat e personelit dhe rreth 28% për shpenzimet e tjera operative. Shpenzimet kapitale, apo investimet, përbëjnë vetëm 3% të planit të shpenzimeve vjetore të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, dhe pwr tremujorin e tretw tw vitit swrish ato paraqesin njw nivel tw ulwt realizimi. Në tërësi, paraqitet një nivel performance i pranueshëm, por me mundwsi pwr pwrmirwsim nw tremujorin e fundit tw vitit.

Nëse konsiderojmë ndarjen sipas programeve, situata paraqitet si më poshtë.

Kodi	Emërtimi i Programit	Përqindja e realizimit kundrejt buxhetit vjetor
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	53.7%
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0.0%
	Totali i institucionit	53.7%

Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, paraqet një përqindje realizimi të shpenzimeve, prej rreth 38.6% në rang institucioni. Shpenzimet korente, paraqiten në nivele relativisht më të ulta se plani i mundshëm i periudhës, si pasojë e mungesës së tre anëtarëve të KQZ-së, të cilët kanë dhënë dorëheqjen në prill të vitit 2013. Ndërkohë, për programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”, nuk janë alokuar fonde për vitin 2014, për faktin në këtë vit nuk do të zhvillohen zgjedhje parlamentare apo lokale.

2. Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

Në raportin e monitorimit të përgatitur nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, janë raportuar zhvillimet për tre produkte buxhetore në programin e “Planifikimi, Administrimi dhe Menaxhimi”, dhe më specifikisht:

- Produkti A: Shpërblimi i anëtarëve dhe administratës së KQZ-së;
- Produkti B: Shpenzime operative në funksion të anëtarëve dhe administratës;
- Produkti C: Pajisje zyre;

Në Aneksin nr. 9 të Raportit të Monitorimit, Formatin nr. 8, “Raporti i realizimit të produkteve të programit”, paraqiten të dhënat mbi realizimin e pjesshëm të dy produkteve të para, dhe mos realizimin e produktit të tretë. Ndërkohë që mirëpreten komentet për arsyet e realizimit të pjesshëm dhe mos-realizimit të produktit të tretë, KQZ duhet të paraqesë edhe realizimin e tyre në raport me planin e periudhës, dhe jo vetëm me planin vjetor.

3. Krahësimi i të dhënave faktike, të raportit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me të dhënat e Thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese.

Ashtu sikurse paraqitur në tabelën e mëposhtme, të dhënat e përdorura nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për tremujorin e tretë të vitit 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i Thesarit.

Në'000 lekë

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	KQZ	MF	Dif	KQZ	MF	Dif.	KQZ	MF	Dif
Planif, Menaxh. dhe Adm.	50,830	50,830	0	203	203	0	51,033	51,033	0
Zgjedhjet e përgjith. dhe lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali i institucionit	50,830	50,830	0	203	203	0	51,033	51,033	0

4. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.

Për programet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë tremujorit të tretw të vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nëmijë lekë

Programet	Buxheti fillestar 2014	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	91.080	98,733	7.653
Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0.0	0.0	0.0
Totali i institucionit	91.080	98,733	7.653

Ndryshimet prej 7.6 milion lekë në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve si pasojë e miratimit të përdorimit të fondit të veçantë të dhënë në zbatim të legjislacionit në fuqi, ndryshimeve të fondeve me Aktin Normativ, dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave.

5. Komente të tjera

- Në raportin e monitorimit, duhet të përfshihet më tepër informacion mbi realizimin e produkteve të programeve buxhetore, të cilat gjithashtu duhet të jenë të lidhura edhe me realizimin e objektivave të politikës së programit.
- Gjithashtu, kërkohet më tepër përpjekje në drejtim të përmirësimit të objektivave dhe produkteve buxhetore, emërtimeve të tyre dhe njësive matëse mbi bazën e të cilave monitorohet performanca e përdorimit të burimeve financiare publike.

6. Publikimi në faqen e internetit

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit të buxhetit për tremujorin e parë të vitit 2014.